

CEL Kosova dhe Departamenti i Punës Sociale

# PËRVOJAT E PERSONAVE LGBTQI+ ME MIGRIMIN

Hulumtuese: Blerona Jashanica & Irela Retkoceri  
Mentore: Prof. Asst. Rita Selimi



# QENDRA PËR BARAZI DHE LIRI TË KOMUNITETEVE LGBT NË KOSOVË (CEL)

**HULUMTUESE: BLERONA JASHANICA & IRELA RETKOCERI**

**MENTORE: PROF. ASST. RITA SELIMI**

Shtator, 2026

COPYRIGHT © CENTRE FOR EQUALITY AND LIBERTY TË GJITHA TË DREJTAT E REZERVUARA. ASNJË PJESË E KËTIJ PUBLIKIMI NUK MUND TË RIPRODHOHET, TË RUHET OSE TË TRANSMETOHET NË ÇFARËDO FORME ELEKTRONIKE, MEKANIKE FOTOKOPJUESE, INCIZUESE APO NDRYSHE, PA LEJEN PARAPRAKE TË CEL KOSOVA.

# Klauzolë e përgjegjësisë

Ky publikim u financua nga SIDA – Agjencia Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ndërkombëtar dhe u realizua në bashkëpunim me Universitetin e Prishtinës. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e vetme e CEL Kosova dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e partnerit dhe donatorit.

# Hyrje

Migrimi është shpjeguar tradicionalisht përmes teorive që e lidhin vendimin për t'u larguar me faktorë ekonomikë, politikë ose të sigurisë, duke e konceptuar migrantin si një individ racional që synon përmirësimin e kushteve të jetesës ose shmangien e rreziqeve në vendin e origjinës. Megjithatë, zhvillimi i studimeve mbi migrimin queer ka sfiduar këtë qasje, duke argumentuar se për personat LGBTQI+ migrimi nuk mund të reduktohet në një lëvizje gjeografike apo në një vendim të motivuar vetëm nga arsye ekonomike. Përkundrazi, ai është një proces kompleks, në të cilin ndërthuren përvojat e stigmatizimit, mirëqenia psikologjike, marrëdhëniet sociale dhe negociimi i vazhdueshëm i identitetit (Alessi, Kahn, & Van Der Horn, 2017). Në këtë kuptim, orientimi seksual dhe identiteti gjinor nuk përbëjnë vetëm karakteristika individuale, por edhe kategori sociale që ndikojnë mënyrën se si individët përjetojnë mjedisin ku jetojnë dhe mundësitë që kanë për të ndërtuar jetën e tyre. Për shumë persona LGBTQI+, vendimi për të migruar lidhet me përvoja të zgjatura të diskriminimit, stigmatizimit, dhunës, refuzimit social dhe kufizimit të autonomisë personale. Si rrjedhojë, migrimi nuk paraqitet vetëm si një strategji për përmirësimin e kushteve materiale të jetesës, por edhe si një përpjekje për të gjetur një mjedis social më gjithëpërfshirës dhe më të sigurt, ku identiteti seksual ose gjinor mund të shprehet lirshëm dhe në mënyrë autentike, pa frikën nga paragjykimi, diskriminimi dhe stigmatizimi. Në këtë kuptim, migrimi mund të shihet si një përpjekje për të ndërtuar një jetë më të qetë, më të sigurt dhe më dinjitoze, në një mjedis ku individët mund të jetojnë dhe të shprehin identitetin e tyre pa kufizimet dhe presionet shoqërore që mund të përjetojnë në vendin e origjinës (Rodriguez & Giametta, 2024; Ramirez et al., 2024).

Nga një perspektivë sociologjike, migrimi i personave LGBTQI+ duhet të kuptohet si një proces i negociimit të vazhdueshëm të përkatësisë sociale. Shoqëritë ndërtojnë norma dhe pritshmëri mbi gjininë, seksualitetin dhe familjen, të cilat përcaktojnë se cilat identitete konsiderohen të pranueshme dhe cilat marginalizohen. Për individët LGBTQI+, veçanërisht në shoqëri ku heteronormativiteti dhe cisnormativiteti mbeten norma dominuese, përkatësia sociale shpesh kushtëzohet nga fshehja ose përshtatja e identitetit. Në këtë kuptim, migrimi përfaqëson jo vetëm largimin nga një hapësirë fizike, por edhe përpjekjen për t'u distancuar nga struktura sociale që kufizon autenticitetin e jetës së përditshme. Megjithatë, literatura tregon se ky proces nuk është linear sepse edhe pas migrimit, shumë individë vazhdojnë të përballen me forma të reja të diskriminimit, racizmit, pasigurisë ligjore dhe përjashtimit social, duke bërë që marginalizimi të mos zhduket, por të marrë forma të reja në kontekstin e vendit pritës (Gottvall et al., 2022; Yarwood et al., 2022). Përvojat e migrimit ndikohen gjithashtu nga ndërthurja e identiteteve dhe pozitive të ndryshme sociale. Qasja e interseksionalitetit argumenton se orientimi seksual ose identiteti gjinor nuk mund të analizohen të ndara nga faktorë të tjerë, si gjinia, etnia, klasa sociale, feja, mosha apo statusi ligjor, pasi këta faktorë ndërveprojnë dhe krijojnë forma të ndryshme të privilegjit ose marginalizimit (Crenshaw, 1989). Si rezultat, përvojat e migrimit nuk janë universale; dy persona LGBTQI+ mund ta përjetojnë të njëjtin proces në mënyra krejtësisht të ndryshme, edhe kur largohen nga i njëjti vend. Krahas dimensionit sociologjik, literatura i kushton vëmendje të veçantë ndikimit psikologjik të migrimit. Shumica e studimeve mbështeten në Minority Stress Theory (Meyer, 2003), që argumenton se pabarazitë në shëndetin mendor të personave LGBTQI+ nuk burojnë nga identiteti seksual ose gjinor në vetvete, por nga ekspozimi i vazhdueshëm ndaj stigmatizimit, diskriminimit dhe përjashtimit social. Sipas kësaj teorie, individët përballen njëkohësisht me stresorë distalë, si diskriminimi, dhuna dhe viktimizimi, dhe me stresorë proksimalë, të tillë si pritja e refuzimit, fshehja e identitetit dhe internalizimi i qëndrimeve negative ndaj vetvetes. Ekspozimi afatgjatë ndaj këtyre stresorëve lidhet me rritjen e rrezikut për ankth, depresion, simptoma post-traumatike dhe ulje të mirëqenies psikologjike (Moorhead, Lewis, & Arnull, 2024; Grigoreva & Szaszko, 2024; Nicholas & Bresin, 2024).

Në kontekstin e migrimit, megjithatë, stresi i minoritetit nuk përfundon me largimin nga vendi i origjinës, përkundrazi, ai ndërthuret me sfidat që lidhen me vetë procesin e migrimit, si pasiguria ligjore, vështirësitë ekonomike, izolimi social, barrierat gjuhësore dhe procesi i integritimit në vendin e ri. Këta stresorë nuk veprojnë në mënyrë të pavarur, por ndërveprojnë dhe e përforcojnë njëri-tjetrin, duke krijuar një barrë të shumëfishtë psikologjike për personat migrantët LGBTQI+ (Yarwood et al., 2022; Gottvall et al., 2022).

Një nga mekanizmat më të studiuar në këtë kontekst është fshehja e identitetit (identity concealment). Edhe pse kjo strategji mund të shërbejë si mekanizëm mbrojtës në mjedise armiqësore, studimet tregojnë se ajo lidhet me nivele më të larta ankthi, vetmie, ulje të vetëvlerësimit dhe vështirësi në ndërtimin e marrëdhënieve autentike. Këto pasoja janë veçanërisht të theksuara për individët që migrojnë nga shoqëri konservatore, pasi shumë prej tyre vazhdojnë ta fshehin identitetin edhe pas migrimit, për shkak të frikës nga refuzimi, humbja e lidhjeve familjare ose stigmatizimi nga komuniteti i origjinës.

Një dimension që ka marrë vëmendje të shtuar në literaturën bashkëkohore është roli i familjes dhe kontekstit kulturor në formësimin e vendimit për të migruar. Shumica e studimeve mbi migrimin LGBTQI+ janë zhvilluar në shoqëri individualiste, ku largimi nga familja shpesh interpretohet si një hap drejt autonomisë dhe afirmimit të identitetit. Megjithatë, kjo qasje nuk e pasqyron plotësisht realitetin e shoqërive kolektiviste, ku familja vazhdon të jetë burimi kryesor i përkatësisë sociale, mbështetjes emocionale dhe legjitimitetit shoqëror (Ammaturo, 2017). Në këto kontekste, orientimi seksual ose identiteti gjinor nuk perceptohen vetëm si çështje individuale, por si elemente që lidhen ngushtë me reputacionin e familjes.

Ky realitet është veçanërisht i rëndësishëm në Ballkanin Perëndimor, përfshirë Kosovën, ku marrëdhëniet familjare dhe normat kolektive vazhdojnë të kenë ndikim të madh në jetën e individit. Edhe pse korniza ligjore në Kosovë ofron mbrojtje formale ndaj diskriminimit mbi bazën e orientimit seksual dhe identitetit gjinor, raportet e viteve të fundit tregojnë se stigma sociale, paragjykimet dhe refuzimi familjar mbeten përvoja të zakonshme për shumë persona LGBTQI+ (ILGA-Europe, 2025; CSGD, 2024). Për pasojë, vendimi për të migruar shpesh nuk lidhet vetëm me kërkimin e mundësive ekonomike, por edhe me nevojën për të jetuar në një mjedis ku siguria personale, autonomia dhe shprehja e identitetit të mos jenë vazhdimisht objekt negociimi. Në këtë kuptim, migrimi nuk duhet të shihet vetëm si largim nga një territor, por si një proces i rindërtimit të përkatësisë. Megjithëse largimi mund të krijojë hapësira më të mëdha për vetëshprehje dhe zhvillim personal, ai shpesh shoqërohet me humbjen e rrjeteve familjare, pasiguri emocionale dhe sfida të reja të integritetit. Kjo e vendos individin në një pozitë paradoksale, ku fitimi i lirisë personale mund të shoqërohet njëkohësisht me humbjen e burimeve tradicionale të mbështetjes sociale. Për këtë arsye, përvojat e migrimit të personave LGBTQI+ nuk mund të kuptohen vetëm përmes teorive klasike të migrimit, por kërkojnë një qasje që ndërthur dimensionin psikologjik të mirëqenies me dimensionin sociologjik të përkatësisë, normave kulturore dhe marrëdhënieve familjare.

Ky studim ka për qëllim të eksplorojë përvojat e personave LGBTQI+ të cilët kanë migruar jashtë Kosovës, të identifikojë faktorët që kanë ndikuar në vendimin për të migruar, si dhe të analizojë mënyrën se si migrimi ka ndikuar në jetësimin e identitetit të tyre seksual ose gjinor, ndjenjën e përkatësisë, mirëqenien psikologjike dhe procesin e integritetit në vendin pritës.

# Metodologjia

Ky studim është realizuar duke përdorur metodën kualitative, e cila është konsideruar më e përshtatshme për të eksploruar në thellësi përvojat subjektive të personave LGBTQI+ që kanë migruar nga Kosova. Duke pasur parasysh natyrën e pyetjeve kërkimore, fokusi i studimit ka qenë në kuptimin e përvojave të jetuara, interpretimeve personale dhe mënyrës se si pjesëmarrësit i japin kuptim migrimit.

Të dhënat janë mbledhur përmes intervistave gjysmë të strukturuar, ky format u zgjodh pasi u lejoi pjesëmarrësve të rrëfenin përvojat e tyre në mënyrë të lirë, duke ruajtur njëkohësisht fokusin në objektivat e studimit.

Pyetjet e intervistave ishin rreth kategorive tematike: Kategoria e parë fokusohet në procesin e migrimit dhe faktorët që ndikuan në vendimin për migrim, duke eksploruar përvojën e migrimit, arsyet që çuan në largimin nga Kosova, si dhe jetën e pjesëmarrësve para dhe pas migrimit.

Kategoria e dytë trajton identitetin, vetëshprehjen dhe ndjenjën e përkatësisë, duke shqyrtuar mënyrën se si migrimi ka ndikuar në identitetin personal dhe seksual të pjesëmarrësve, në shprehjen e vetvetes, në ndjenjën e përkatësisë në vendin pritës dhe në kuptimin që ata i japin konceptit të "shtëpisë".

Kategoria e tretë fokusohet në marrëdhëniet sociale, ndryshimet pas migrimit dhe reflektimet mbi përvojën e migrimit, duke eksploruar ndryshimet personale dhe sociale të përjetuara pas migrimit, ndikimin e marrëdhënieve me familjen, shoqërinë dhe komunitetin, si dhe reflektimet dhe mesazhet që pjesëmarrësit dëshirojnë të ndajnë lidhur me përvojat e personave LGBTQI+ që migrojnë.

## MOSTRA

Studimi është realizuar me pesë pjesëmarrës (n= 5), të cilët janë persona LGBTQI+ me origjinë nga Kosova dhe aktualisht jetojnë jashtë vendit. Nga pjesëmarrësit, një (n=1) është identifikuar si grua me orientim seksual lezbike, ndërsa katër (n=4) janë identifikuar si burra me orientim seksual gej.

Përzgjedhja e pjesëmarrësve është bërë përmes mostres së topit të bores (snowball sampling). Kjo teknikë është zgjedhur për shkak se personat LGBTQI+ që kanë migruar përbëjnë një popullatë relativisht të vështirë për t'u identifikuar dhe kontaktuar, ndërsa temat e trajtuara janë të ndjeshme dhe kërkojnë një nivel të lartë besimi. Përmes rekomandimeve të pjesëmarrësve fillestarë u bë e mundur identifikimi i personave të tjerë që plotësonin kriteret e përfshirjes në studim. Realizimi i intervistave është bërë online.

## ANALIZA E TË DHËNAVE

Të dhënat e mbledhura janë analizuar duke përdorur analizën tematike (Thematic Analysis). Kjo metodë u përzgjedh sepse mundëson identifikimin, organizimin dhe interpretimin sistematik të modeleve (temave) që shfaqen në të dhënat. Analiza tematike ofron fleksibilitet metodologjik dhe është veçanërisht e përshtatshme për studime që synojnë të kuptojnë përvojat e jetuara dhe kuptimet që individët u atribuojnë atyre. Procesi i analizës përfshiu leximin e përsëritur të transkripteve, kodimin fillestar të të dhënave, grupimin e kodeve në tema të përbashkëta, rishikimin dhe rafinimin e temave, si dhe interpretimin e tyre në raport me pyetjet kërkimore dhe literaturën ekzistuese.

## REZULTATET

Analiza tematike e intervistave identifikoi pesë tema kryesore që përshkruajnë përvojat e personave LGBTQI+ lidhur me migrimin nga Kosova. Këto tema janë: (1) Migrimi si rruga drejt një jete autentike, (2) Liria për të jetuar dhe shprehur identitetin, (3) Përmirësimi i mirëqenies psikologjike pas migrimit, (4) Mes lirisë dhe ndjenjës së mos-përkatësisë, dhe (5) Marrëdhëniet familjare përtej migrimit.

### TEMA 1. MIGRIMI SI RRUGA DREJT NJË JETE AUTENTIKE

Për të tre pjesëmarrësit, migrimi nuk u përshkrua si një vendim i motivuar kryesisht nga arsye ekonomike, por si një mënyrë për të jetuar në përputhje me identitetin e tyre seksual. Edhe pse rrethanat e migrimit ndryshonin, pjesëmarrësit ndanin bindjen se në Kosovë e kishin të pamundur ta ndërtonin jetën në mënyrën që dëshironin. Presioni për martesë, pritjet shoqërore dhe nevoja për ta fshehur identitetin ishin ndër faktorët që ndikuan në vendimin për t'u larguar.

Njëri prej pjesëmarrësve e përshkroi presionin e vazhdueshëm që përjetonte në Kosovë:

"Po mendoj presionit për me kriju familje, pyetjeve konstant që i kam mar se pse spe gjen naj qik, cka je tu prit, vec ti mete e krejt qeto, shka do që kam bo tjetër me pune nuk ka pas rendesi pervec faktit që u dasht me u rahatu."

Një pjesëmarrëse tjetër e përshkroi migrimin si zgjedhje mes një jete të kufizuar dhe mundësisë për ta jetuar jetën në mënyrë autentike:

"...une e kom pas vec dy zgjidhje ne kete jete edhe e kom zgjedh me jetu. "

Ndërsa një pjesëmarrës tjetër, megjithëse migrimi lidhej fillimisht me partnerin e tij, e përshkroi atë si mundësi për ta jetuar më lirshëm identitetin e tij.

Përveç motivimeve që lidhen me kërkimin e një jete më autentike, pjesëmarrësit përshkruan edhe procesin e migrimit si një periudhë emocionale të vështirë. Largimi nga vendi i origjinës shoqërohej me pasiguri, frikë nga e panjohura, vetmi dhe mall për familjen. Kështu, edhe pse migrimi u perceptua si një hap drejt lirisë, ai njëkohësisht tregonte një proces të ndarjes nga mjedisi i njohur dhe riformësimit të jetës personale. Në përgjithësi, pjesëmarrësit e përjetuan migrimin si një hap të domosdoshëm drejt ndërtimit të një jete ku mund të ishin vetvetja.

### TEMA 2. LIRIA PËR TË JETUAR DHE SHPREHUR IDENTITETIN

Një nga ndryshimet më të rëndësishme që pjesëmarrësit përshkruan pas migrimit ishte mundësia për ta shprehur identitetin e tyre seksual në mënyrë më të hapur. Për dallim nga përvojat në Kosovë, ku shumë prej tyre ndiheshin të detyruar ta fshihnin orientimin seksual, në vendin pritës ata përjetuan më shumë liri në marrëdhëniet personale, në vendin e punës dhe në ndërveprimet e përditshme.

Njëri prej pjesëmarrësve tha:

"Une kur kam shkel ne Gjermani kam thon, mo kon ta njoftoj ka me dijt vec kush jom, kerkujt skom me rrejt..."

I njëjti pjesëmarrës shtoi:

"...ne pune e dijne, ku shkoj e dijne qe jam shka jam kush jam e qekjo me bon e pa veten shume te shlirum."

Një tjetër pjesëmarrës e përshkroi rëndësinë e mundësisë për ta jetuar hapur marrëdhënien me partnerin:

"kom mujt me kriju lidhje kshtu tamon si strejterat qysh e bojne, e jo vec per hajt po psh me dal me partner temin, me u kon tamon te dashurum."

Megjithatë, me kalimin e kohës, disa pjesëmarrës raportuan se krijimi i marrëdhënieve të reja dhe njohja me persona që ndanin vlera të ngjashme kontribuan në ndërtimin e një ndjenje më të madhe sigurie dhe përkatësie. Këto përvoja tregojnë se migrimi u krijoi pjesëmarrësve hapësirë për ta jetuar identitetin e tyre në mënyrë më autentike dhe pa nevojën e vazhdueshme për fshehje.

### **TEMA 3. PËRMIRËSIMI I MIRËQENIES PSIKOLOGJIKE PAS MIGRIMIT**

Përveç ndryshimeve në mënyrën e shprehjes së identitetit, pjesëmarrësit përshkruan edhe ndryshime të rëndësishme në mirëqenien e tyre psikologjike. Ata raportuan ulje të ankthit, rritje të vetëbesimit dhe ndjenja më të mëdha qetësie dhe lumturie pas migrimit.

Njëri prej pjesëmarrësve e përshkroi këtë përvojë me fjalët:

"E pas migrimit tasht me duket shume sikur kur mar fryme lirshem."

Një pjesëmarrës tjetër tha:

"Liria qe e kom mar ndoshta ka qene ma e mira, mandej bashke me to psiqika jeme, ndjena shume ma mire, krejt ankthi qe e kom pas mo mdoket nuk eshte prezent."

Ndërsa pjesëmarrësja e tretë tregoi se vetëm pas migrimit kishte kuptuar ndikimin emocional që kishte pasur jeta në Kosovë:

"E kom pa sa shumë jom kon e mllfosur... m'ka vyjt shumë kohë me fal veten që s'kom ik ma herët. E tasht ndjena shume e permbushur."

Në tërësi, pjesëmarrësit e përshkruan migrimin si një përvojë që ndikoi pozitivisht në mirëqenien e tyre psikologjike dhe në mënyrën se si e perceptonin veten.

### **TEMA 4. MES LIRISË DHE NDJENJËS SË MOS-PËRKATËSISË**

Megjithëse pjesëmarrësit përjetuan më shumë liri pas migrimit, ata njëkohësisht përshkruan sfida që lidhen me ndjenjën e përkatësisë në vendin pritës. Integrimi, ndërtimi i marrëdhënieve të reja dhe ndjenja e të qenit emigrant u përmendën si përvoja të përbashkëta.

Përveç sfidave të lidhura me identitetin dhe përkatësinë, pjesëmarrësit u përballën edhe me sfida praktike të integritetit, përfshirë përshtatjen me gjuhën, kulturën dhe normat sociale të vendit pritës. Në këtë kontekst, migrimi ndikoi edhe në riformësimin e kuptimit të konceptit “shtëpi”. Për pjesëmarrësit, shtëpia nuk përcaktohej më vetëm nga vendi i lindjes apo origjina kombëtare, por nga mundësia për të qenë të pranuar dhe për të jetuar pa nevojën për fshehje të identitetit. Kjo sugjeron se ndjenja e përkatësisë për personat LGBTQI+ lidhet ngushtë me sigurinë emocionale dhe pranimin social.

Njëri prej pjesëmarrësve u shpreh:

"Ketu eshte zorr, vec kush ka shume shoqni se perndryshe sidomos fillimit jane shume zorr po kadal e mer veten amo apet nuk ki kshtu hapesire ose nuk eshte qe njerezve l intereson per ty, je shume i vetmum."

Një pjesëmarrës tjetër tha:

"Nuk ndjehesh ne shpi kurre por eshte normale ne vend te huaj se prape si emigrant jeta eshte ndryshe, mundesh me pas jeten e mire me te ardhura e lumturi po kete ndjenjen qe je i huaj e ki gjithmone."

Edhe pjesëmarrësja e tretë ndau një përvojë të ngjashme:

"Hmm une nuk kom ende shume shoqni por nuk ndjehesh ne shpi por ma mire e lire se ne shpi ku ste pranojne." Këto përvoja sugjerojnë se, ndonëse migrimi u ofroi pjesëmarrësve më shumë liri për ta jetuar identitetin e tyre, ai nuk e eliminoi plotësisht ndjenjën e mos-përkatësisë.

## **TEMA 5. MARRËDHËNIET FAMILJARE PËRTEJ MIGRIMIT**

Marrëdhëniet me familjen vazhduan të luanin rol të rëndësishëm edhe pas migrimit. Për shumicën e pjesëmarrësve, largimi nga Kosova nuk nënkuptonte fundin e sfidave që lidhen me pranimin e identitetit të tyre seksual. Disa vazhdonin ta fshihnin orientimin seksual nga pjesa më e madhe e familjes, ndërsa të tjerë përshkruan se largësia fizike e kishte lehtësuar menaxhimin e pritjeve familjare, por jo domosdoshmërisht marrëdhëniet.

Njëri prej pjesëmarrësve tha:

"Familjen e du shume e sdu me lendu, perveq nanes tem askush tjeter nuk e din per mu, vazhdoj mire e foli e shihna por eshte veshtire mi rrejt."

Një pjesëmarrës tjetër u shpreh:

"Ata kerkush se din per mu qe se kane dijt ma perapra, nuk ka ndiku naj sen po vec qe jam bo ma i afert tek ma larg njeri po u merzitke a shume."

Ndërsa pjesëmarrësja e tretë tha:

"Hmm une foli e i shoh shpesh, nuk kane ndiku naj dishka keq une presion kom halo por tasht ma larg e po muj ma mos mu mar me ta por me thon eshte i njejt i relacion."

Në disa raste, migrimi ndikoi edhe pozitivisht në raportet familjare. Njëri prej pjesëmarrësve tregoi se përmirësimi i gjendjes ekonomike kishte ndikuar në marrëdhënien me familjen:

"Te ardhurat ma te mdhaja... kjo e ka permirsu raportin tem me familjen shume."

Në përgjithësi, gjetjet tregojnë se, edhe pse migrimi krijoi distancë fizike nga familja dhe reduktoi disa forma të presionit të përditshëm, marrëdhëniet familjare dhe nevoja për të negociuar identitetin mbetën pjesë e rëndësishme e përvojës së pjesëmarrësve.

# Diskutimi

Ky studim kishte për qëllim të eksplorojë përvojat e personave LGBTQI+ nga Kosova që kanë migruar jashtë vendit, me fokus në faktorët që ndikuan në vendimin për migrim, mënyrën se si migrimi ndikoi në jetësimin e identitetit të tyre seksual ose gjinor, mirëqenien psikologjike, ndjenjën e përkatësisë dhe marrëdhëniet familjare. Analiza tematike identifikoi pesë tema kryesore, të cilat tregojnë se migrimi për pjesëmarrësit nuk përfaqësonte vetëm një ndryshim gjeografik, por një proces të ndërlikuar të kërkimit të sigurisë, autenticitetit dhe mirëqenies.

Një nga gjetjet kryesore të studimit ishte se pjesëmarrësit nuk e përjetuan migrimin si një vendim të motivuar kryesisht nga arsye ekonomike, por si një mënyrë për të jetuar në përputhje me identitetin e tyre seksual. Presioni për martesë, pritjet heteronormative dhe nevoja për ta fshehur orientimin seksual u identifikuan si faktorë të rëndësishëm që ndikuan në vendimin për t'u larguar nga Kosova. Kjo përputhet me literaturën mbi migrimin queer, e cila argumenton se për personat LGBTQI+, migrimi shpesh lidhet me kërkimin e një mjedisi ku identiteti seksual ose gjinor mund të shprehet lirshëm dhe në mënyrë të sigurt, më shumë sesa me përfitimet ekonomike (Rodriguez & Giametta, 2024; Ramirez et al., 2024). Në mënyrë të veçantë, deklaratat e pjesëmarrësve se migrimi ishte "zgjidhja e vetme" për të jetuar jetën që dëshironin pasqyrojnë idenë se largimi nga vendi i origjinës perceptohej si një domosdoshmëri dhe jo si një zgjedhje e lirë.

Një tjetër gjetje e rëndësishme ishte ndikimi i migrimit në mënyrën se si pjesëmarrësit e jetonin dhe e shprehnin identitetin e tyre seksual. Të gjithë pjesëmarrësit përshkruan se pas migrimit ndiheshin më të lirë për të qenë të hapur në marrëdhëniet personale, në vendin e punës dhe në jetën e përditshme. Për disa prej tyre, kjo nënkuptonte fundin e nevojës për të fshehur identitetin, ndërsa për të tjerë për herë të parë u bë e mundur të ndërtonin marrëdhënie romantike në mënyrë të hapur. Këto gjetje janë në përputhje me studimet që theksojnë se migrimi mund të krijojë hapësira më të sigurta për afirmimin e identitetit dhe reduktimin e nevojës për fshehje (Rodriguez & Giametta, 2024). Megjithatë, fakti që pjesëmarrësit e përshkruanin jetën në Kosovë si një "jetë të dyfishtë" tregon se fshehja e identitetit kishte qenë pjesë e përditshmërisë së tyre përpara migrimit, duke reflektuar ndikimin e normave heteronormative dhe cisnormative në kontekstin e vendit të origjinës.

Rezultatet treguan gjithashtu se migrimi u shoqërua me përmirësim të ndjeshëm të mirëqenies psikologjike. Pjesëmarrësit raportuan ulje të ankthit, rritje të vetëbesimit dhe ndjenja më të mëdha lirie dhe qetësie emocionale. Këto gjetje mbështesin Minority Stress Theory (Meyer, 2003), sipas së cilës problemet e shëndetit mendor tek personat LGBTQI+ nuk burojnë nga orientimi seksual ose identiteti gjinor në vetvete, por nga ekspozimi i vazhdueshëm ndaj diskriminimit, stigmatizimit dhe fshehjes së identitetit. Përshkrimet e pjesëmarrësve, si ndjenja se "marrin frymë lirshëm" ose se ankthi nuk është më i pranishëm, sugjerojnë se largimi nga një mjedis ku përjetonin stres të vazhdueshëm mund të ketë reduktuar disa nga stresorët e minoritetit. Këto rezultate janë në përputhje edhe me studimet e Moorhead et al. (2024), Grigoreva dhe Szaszko (2024) dhe Nicholas dhe Bresin (2024), të cilat raportojnë se ekspozimi i zgjatur ndaj diskriminimit lidhet me mirëqenie më të ulët psikologjike.

Megjithatë, rezultatet tregojnë se migrimi nuk i eliminoi të gjitha sfidat me të cilat përballeshin pjesëmarrësit. Edhe pse ata përjetuan më shumë liri, të gjithë përshkruan ndjenjën e vetmisë, vështirësitë në krijimin e rrjeteve sociale dhe ndjenjën e vazhdueshme të të qenit "i huaj" në vendin pritës. Këto gjetje përputhen me studimet e Gottvall et al. (2022) dhe Yarwood et al. (2022), të cilat argumentojnë se migrimi nuk e zhduk marginalizimin, por shpesh e transformon atë.

Në vend të presionit të lidhur me orientimin seksual, individët mund të përballen me sfida të reja që lidhen me integrimin, izolimin social, statusin e migrantit ose mungesën e rrjeteve mbështetëse. Në këtë kuptim, përvojat e pjesëmarrësve ilustrojnë kompleksitetin e migrimit, ku fitimi i lirisë personale mund të shoqërohet njëkohësisht me humbjen e ndjenjës së përkatësisë.

Një aspekt tjetër i rëndësishëm i gjetjeve ishte roli i vazhdueshëm i familjes edhe pas migrimit. Edhe pse largësia fizike ua kishte lehtësuar pjesëmarrësve menaxhimin e pritjeve familjare, shumica vazhdonin ta fshihnin orientimin seksual nga pjesëtarët e familjes ose ndiheshin të detyruar të negocionin vazhdimisht identitetin e tyre. Kjo sugjeron se migrimi nuk i ndërpret domosdoshmërisht lidhjet me familjen ose ndikimin e normave kulturore të vendit të origjinës. Këto rezultate mbështesin argumentin e Ammaturo (2017), sipas të cilit në shoqëritë kolektiviste familja mbetet burimi kryesor i përkatësisë sociale dhe legjitimitetit, duke bërë që vendimet dhe përvojat individuale të ndikohen vazhdimisht nga marrëdhëniet familjare. Në kontekstin e Kosovës, ku raportet e ILGA-Europe (2025) dhe CSGD (2024) tregojnë se stigma dhe refuzimi familjar vazhdojnë të jenë të pranishme, këto gjetje sugjerojnë se distanca gjeografike nuk është gjithmonë e mjaftueshme për ta eliminuar plotësisht ndikimin e këtyre normave.

Në tërësi, rezultatet e këtij studimi tregojnë se migrimi për personat LGBTQI+ nga Kosova nuk mund të kuptohet vetëm si lëvizje drejt një vendi tjetër, por si një proces i rindërtimit të identitetit, mirëqenies dhe përkatësisë. Për pjesëmarrësit, migrimi krijoi mundësi më të mëdha për të jetuar në mënyrë autentike dhe për të përmirësuar mirëqenien psikologjike, por njëkohësisht solli sfida të reja që lidhen me integrimin, vetminë dhe ruajtjen e marrëdhënieve familjare. Këto gjetje mbështesin argumentin se përvojat e migrimit të personave LGBTQI+ duhet të analizohen përmes një qasjeje që ndërthur dimensionet psikologjike, sociale dhe kulturore, duke marrë parasysh jo vetëm faktorët që i shtojnë individët të migrojnë, por edhe mënyrën se si ata vazhdojnë të negociojnë identitetin dhe përkatësinë edhe pas migrimit.

# Referenca

Alessi, E. J., Kahn, S., & Van Der Horn, R. (2017). A Qualitative Exploration of the Premigration Victimization Experiences of Sexual and Gender Minority Refugees and Asylees in the United States and Canada. *The Journal of Sex Research*, 54(7), 936–948. <https://doi.org/10.1080/00224499.2016.1229738>

Meyer, I. H. (2003). Prejudice, social stress, and mental health in lesbian, gay, and bisexual populations: Conceptual issues and research evidence. *Psychological Bulletin*, 129(5), 674–697. <https://doi.org/10.1037/0033-2909.129.5.674>

Crenshaw, K. (1989). Demarginalizing the intersection of race and sex: A Black feminist critique of antidiscrimination doctrine, feminist theory and antiracist politics. *University of Chicago Legal Forum*, 1989(1), 139–167

Gottvall, M., O. Péter-Szabó, R. Isaac, C. Aav, E. Norgren, and T. Carlsson. 2025. “ Sexual and Gender Minority Migrants' Experiences of Health Service Access and Utilisation: A Qualitative Meta-Synthesis.” *Journal of Clinical Nursing* 34, no. 10: 4448–4461. <https://doi.org/10.1111/jocn.17683>

Yarwood, V.; Checchi, F.; Lau, K.; Zimmerman, C. LGBTQI + Migrants: A Systematic Review and Conceptual Framework of Health, Safety and Wellbeing during Migration. *Int. J. Environ. Res. Public Health* 2022, 19, 869. <https://doi.org/10.3390/ijerph19020869>

Rodriguez, D.G. & Giametta, C. (2024) Queer asylum: Between hostility and incredibility. *International Migration*, 62, 232–236. Available from: <https://doi.org/10.1111/imig.13221>

Moorhead, B., Lewis, H.K. & Arnull, L. LGBT sexuality and gender minority experiences of minority stress: a comparison of models and theories. *Qual Quant* 58, 3973–4001 (2024). <https://doi.org/10.1007/s11135-023-01771-z>

Grigoreva, D., & Szaszó, B. (2024). Minority stress and psychological well-being in queer populations. *Scientific reports*, 14(1), 27084. <https://doi.org/10.1038/s41598-024-78545-6>

Nicholas, J., & Bresin, K. (2024). Everyday sexual and gender minority stress and health: A systematic review of experience sampling studies. *Archives of Sexual Behavior*, 53(4), 1221–1243. <https://doi.org/10.1007/s10508-023-02779-0>

